



K.DH.SH.II.nr.955/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit American Hospital Kosova Sh.P.K me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Virtyt Ibrahimaga nga Prishtina, , kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1727/19 të datës 15.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.10.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, paditësit American Hospital Kosova Sh.P.K me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A.nr.1727/19 të datës 15.04.2021, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit American Hospital Kosova Sh.P.K me seli në Prishtinë, ndërsa është lënë në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.07.3/682/2015, i datës 21.06.2019.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet në tërësi si e pabazuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal A.nr. 1727/19 datë 15.04.2021, dhe të i kthehet të njëjtës në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr. 07.3/682/2015 datë 21.06.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, American Hospital Kosova Sh.P.K me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin ndaj aktvendimit nr. 05.1/369 i datës 18.06.2015, të lëshuar nga Sektori për Kontroll Pas Importues.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ Divizion Fiskal. Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesorë më dt.15.04.2021, si në vështrim të nenit 41 të LKA, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lenë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, sipas theksimeve në arsyetim se: “Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar drejtë kur është nxjerr konkluzioni se paditësi ka bërë deklaram të pasaktë në kuptim të kodit tarifor të mallit lëndor të deklaruar me Deklaratat Unike Doganore R-

4287/15.02.2013 R-9493/30.03.2013 Vërmice – Terminal dhe është obliguar të paguaj taksat doganore shtesë pasi që nga mostrat e mallit lëndor të marra nga vizita e kontrollit doganor tek paditësi ka rezultuar se përshkrimi i saktë i mallit lëndor është printer që lidhen me një makinë automatike të dhënave apo rrjet Eko – Printer në kodin tarifor 8443 32 10 90 dhe malli Aparatura për filtrimin apo pastrim të ajrit: aparat mjekësor për filtrimin e pastrim të ajrit në kodin tarifor 8421 39 20 90. Paditësi nuk ka provuar para gjykatës me asnjë dokument nga shteti eksportues apo prodhuesi i mallit lëndor, të ofroj informatat detyruese tarifore të mallit lëndor, që do të dëshmonin kodin tarifor të mallit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Kodit doganor dhe LPA, siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LKA dhe LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare, si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të Doganës së Kosovës, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 41 të LKA.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sepse nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim. Gjithashtu, kolegji vlerëson se Organi administrativ, e në rastin konkret Dogana e Kosovës, në bazë të nenin 82 të KDA, i cili përcakton se: *“1. Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirim të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirim të mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. 3. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmer masat e duhura për të*

rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”, në rastin konkret janë evidentuar deklarime të mallrave mbi bazën e informatave të pasakta, ku ka rezultuar në rastin konkret me pagesë më të vogël të taksave doganore, Sektori i Kontrollit Pas Importues ka të drejt ta obligoj personin për pagesën e taksave shtesë. Gjykata nuk i pranoi si të mjaftueshme dokumentacionet që ka paraqit paditësi për të dëshmuar saktë klasifikimin tarifor të mallit lëndor të importuar nga shteti eksportues Itali, nuk janë paraqit dëshmitë nga shteti eksportues (BTI) se malli lëndor klasifikohet në kodin tarifor të cilin ka pretenduar.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se e paditura në bazë të autorizimeve që ka me nenin 82 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 ka vërtetuar drejte gjendjen faktike ku ka rezultuar se malli në fjalë i importuar nuk lirohet prej taksës doganore dhe se nga Mendimi për klasifikim tarifor nr.35/T datë 2304.2015 dhe nr.30/T datë 20.04.2015 i Sektorit të Tarifës, gjykata vlerëson se ky mendim tarifor është i referuar në rregullat e përgjithshme 1-6 për interpretim të TARIK-2013, shënimeve të seksionit XVI e XVIII shënimeve të kapitullit 84, 90 dokumenteve me DUD-a, shpjegimeve plotësuese të kreut 8443 dhe 9018. Prandaj gjykata nuk gjen prova se paditësi ka ofruar dëshmit gjegjësisht informatat detyruese tarifore nga shteti eksportues, për të vërtetuar se vërtet malli lëndor klasifikohet në kodin tarifor nr.9018 19 90 00 të deklaruar sipas DUD-ave kontestues datë 15.02.2013 dhe 30.03.2013.

Pretendimet ankimore të paditësit, nga shkaqet ankimore të cekura si më lartë, si dhe theksimet e tjera si në arsyetim, kolegji i shqyrtoi në baza ligjore dhe i refuzon si të paqëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës administrative të LKA-së, apo të LPK-së, ligj i zbatueshëm, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë sipas çështjes në shqyrtim.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka

aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesat, e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.955/22, me datë 12.10.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**